

With funding from

 Austrian
Development
Cooperation

 **GBWN**
GENDER BUDGET WATCHDOG NETWORK

 Sverige

Kapërcimi i hendekut gjinor në bujqësinë rezistente ndaj klimës: Dëshmi nga Rahoveci dhe Podujeva

Janar 2026



Mbështetur nga:



Implementuar nga:

 Democracy
Plus



**KAPËRCIMI I HENDEKUT
GJINOR NË BUJQËSINË
REZISTENTE NDAJ KLIMËS:
DËSHMI NGA RAHOVECI
DHE PODUJEVA**

AUTOR:

Albana Rexha
Analiste e lartë e politikave



Vizitoni webfaqen tonë
www.dplus.org

Zbuloni më shumë për publikimin tonë të fundit,
lajmet, infografikat online.



Na gjeni në Facebook
[@democracyplus](https://www.facebook.com/democracyplus)



Na gjeni në LinkedIn
[@democracy-plus](https://www.linkedin.com/company/democracy-plus)



Na gjeni në Twitter
[@democracy_plus](https://twitter.com/democracy_plus)



Na gjeni në Youtube
[@Democracy-Plus](https://www.youtube.com/Democracy-Plus)

Zyrat tona:

Rruga Bajram Kelmendi, Nr.92, Kati V
Prishtinë, 10000
Kosovë

+383 (0) 38 749 288
info@dplus.org

Ky shënim i shkurtër politikash është shkruar në gjuhën angleze, andaj për çdo paqartësi në këtë version të përkthyer dhe përshtatur, të lutem konsultohuni me versionin origjinal “Bridging the Gender Gap in Climate-Resilient Agriculture: Evidence from Rahovec and Podujevë”.

Ky dokument politikash është zhvilluar në kuadër të projektit “Subvencionet Bujqësore të Ndjeshme ndaj Gjinisë: Rritja e Qëndrueshmërisë Klimatike te Gratë Fermere në Podujevë dhe Rahovec”, i mbështetur nga Rrjeti i Grave të Kosovës (KWN) përmes Rrjetit Mbikëqyrës të Buxhetit Gjikor II (GBWN). Ky publikim financohet nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Suedia. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Democracy Plus (D+) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e ADA-s, Suedisë, GBWN-së apo KWN-së.

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	6
Metodologjia	7
Analiza e të dhënave	9
Përfaqësimi:	9
Burimet:.....	12
Gjendja reale:	16
Rekomandimet:	17
Përfundim	19
ANEKSI I: Pyetjet udhëzuese për grupet e fokusit.....	20
ANEKSI II: Pyetjet udhëzuese për intervistat gjysmë të strukturuar me komunat	21

Hyrje

Kjo analizë gjinore ka për qëllim të analizojë pabarazitë, si dhe mundësitë e lidhura me gjininë në sektorin e bujqësisë, si pasojë e ndryshimeve klimatike në komunat e Podujevës dhe Rahovecit. Këto dy komuna përfaqësojnë zona me rëndësi të veçantë për bujqësinë në Kosovë, duke ofruar një bazë të vlefshme empirike për të kuptuar mënyrën se si ndërveprojnë dinamikat gjinore dhe ndryshimet klimatike në sisteme të ndryshme bujqësore dhe në ekonomitë lokale përkatëse.

Së pari, komuna e Podujevës paraqet një strukturë kryesisht rurale, meqë më shumë se 70% e popullsisë është e vendosur në zona rurale, dhe ka burime të konsiderueshme për zhvillimin e bujqësisë. Sipërfaqja e përgjithshme e tokës së punueshme arrin rreth 33,295 hektarë, prej të cilave 56% shfrytëzohet për kullota, 16% për livadhe, ndërsa pjesa tjetër për kultivimin e perimeve.¹ Së dyti, komuna e Rahovecit e konsideron bujqësinë si sektor me potencial të madh për nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal. Kjo komunë njihet gjerësisht për kultivimin e hardhisë së rrushit, e cila shtrihet në afërsisht 2,400 hektarë, prej të cilëve rreth 75% janë të dedikuara për prodhimin e rrushit të verës dhe 25% për rrush tavoline. Përveç kësaj, në këtë komunë kultivohen rreth 2,300 hektarë me perime, si specat dhe patatet, si dhe rreth 2,500 hektarë për prodhimin e drithërave.

Në këtë kontekst, analiza synon të gjenerojë të dhëna dhe njohuri që do të mbështesin integrimin e perspektivës gjinore në politikat lokale bujqësore dhe në ndërhyrjet e lidhura me ndryshimet klimatike. Në mënyrë përfundimtare, gjetjet e kësaj analize do të shërbejnë si bazë orientuese për hartimin e masave të synuara që forcojnë qëndrueshmërinë e grave fermere ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike në të dyja komunat.

E udhëhequr nga standardet e Institutit Evropian për Barazi Gjinore (EIGE), kjo analizë gjinore synon të:

- të njohë dallimet ndërmjet dhe brenda grupeve të ndryshme të grave dhe burrave, të bazuara në shpërndarjen e pabarabartë të burimeve, mundësive, kufizimeve dhe pushtetit;
- të sigurojë që nevojat e ndryshme të grave dhe burrave të identifikohen qartë dhe të adresohen në të gjitha fazat e ciklit të politikave, nga hartimi deri te zbatimi dhe vlerësimi;
- të njohë ndikimet e ndryshme që politikat, programet dhe projektet mund të kenë mbi gratë dhe burrat;
- të mbledhë dhe të artikulojë perspektivat e grave dhe burrave, duke e bërë kontributin e tyre pjesë thelbësore të procesit të zhvillimit të politikave, programeve dhe projekteve;
- të nxisë ndërhyrje më të informuara, gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj gjinisë dhe klimës në sektorin e bujqësisë.²

Analiza është e strukturuar si vijon: seksioni i parë paraqet kornizën metodologjike, pas tij analiza e të dhënave, ndërsa në fund prezantohen një sërë rekomandimesh të bazuara në prova, të paraqitura në seksionin e realizimit.

1 Shih Komuna e Podujevës. *Plani Zhvillimor Komunal (2016-2025)*. shtator 2015. E disponueshme në: https://podujeve.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/02/PZHK-Podujeve_FINAL.pdf

2 Institutit Evropian për Barazi Gjinore. (2019). *Gender Mainstreaming. Gender Analysis*. E disponueshme në <http://eige.europa.eu/gender-mainstreaming>

Metodologjia

Kjo analizë gjinore përdor metodën 4R, e cila mundëson një shqyrtim gjithëpërfshirës të dinamikave gjinore duke u fokusuar në katër dimensione kyçe: Përfaqësimi, Burimet, Gjendja reale dhe Rekomandimet.

PËRFAQËSIMI (REPRESENTATION): Ky dimension shqyrton dhe analizon shpërndarjen gjinore, bazuar në të dhëna të ndara sipas gjinisë, në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në sektorin e bujqësisë në komunat e Podujevës dhe Rahovecit, për një periudhë tri vjeçare (2022–2024).

Të dhënat që analizohen përfshijnë:

- a) përbërjen e stafit të departamentit sipas gjinisë, përfshirë pozitat drejtuese (drejtor), zyrtarët dhe të gjitha nivelet e tjera të personelit;
- b) përbërjen sipas gjinisë të komisionit që harton thirrjet për subvencione dhe përcakton kriteret e përfitimit, si dhe vlerësimin nëse analiza gjinore dhe ndikimi i ndryshimeve klimatike janë marrë parasysh gjatë hartimit të këtyre thirrjeve;
- c) përbërjen sipas gjinisë të komisionit që vlerëson aplikimet;
- d) bazën ligjore për përbërjen e komisioneve, me qëllim të verifikimit nëse ekzistojnë kritere për mënyrën e përzgjedhjes së anëtarëve të tyre.

BURIMET (RESOURCES): Ky dimension shqyrton ndarjen e burimeve — informacionit, kohës dhe mjeteve financiare — ndërmjet grave dhe burrave fermerë. Analiza udhëhiqet nga pyetjet vijuese:

- a) mënyra se si fermerët janë informuar për thirrjet dhe kriteret përkatëse, niveli i ndjeshmërisë gjinore i metodave të përdorura për informim, si dhe nëse janë përdorur qasje të ndryshme ndaj grave dhe burrave fermerë;
- b) numri i grave dhe burrave fermerë që kanë përfituar nga thirrjet për subvencione gjatë tri viteve të fundit (2022–2024);
- c) numri i grave dhe burrave fermerë përfitues gjatë periudhës 2022–2024;
- d) shuma e mjeteve financiare të përfituara nga gratë dhe burrat fermerë gjatë periudhës 2022–2024;
- e) numri i aplikimeve të pranuar nga gratë dhe burrat fermerë nga komunat e Podujevës dhe Rahovecit gjatë tri viteve të fundit, për secilën thirrje të publikuar;
- f) numri i fermerëve të regjistruar në komunat e Podujevës dhe Rahovecit, sipas gjinisë, si dhe numri i fermerëve aktivë.

GJENDJA REALE (REALIA): Ky dimension hulumton faktorët themelorë socialë, kulturorë dhe institucionalë që kontribuojnë në pabarazitë gjinore të identifikuar në dimensionet e përfaqësimit dhe burimeve. Për të siguruar njohuri të drejtpërdrejta nga fermerët, D+ ka realizuar dy diskutime në fokus grupe — nga një në secilën komunë — me gra dhe burra fermerë (pyetjet në Aneksin I), si dhe nga një intervistë në secilën komunë me përfaqësues të departamenteve të bujqësisë (pyetjet në Aneksin II).

Këto diskutime shqyrtojnë:

- a) mënyrën se si ndryshimet klimatike po ndikojnë në punën bujqësore të grave dhe burrave nga grupe të ndryshme shoqërore;
- b) nëse reagimet komunale dhe mekanizmat mbështetës kanë marrë parasysh këto ndikime të diferencuara gjinore të ndryshimeve klimatike, përfshirë edhe në kuadër të thirrjeve për subvencione;
- c) se si normat shoqërore, përgjegjësitë e kujdesit, qasja në tregje dhe faktorë të tjerë kontekstualë ndikojnë në aftësinë e grave për t'u angazhuar dhe për të përfituar nga aktivitetet bujqësore.

Fokus grupet do të përdorin teknika të hapura dhe pjesëmarrëse për të siguruar dialog gjithëpërfshirës dhe një kuptim të thelluar të sfidave ndërsektoriale.

REKOMANDIMET (REALIZATION): Dimensioni përfundimtar i analizës sintetizon gjetjet nga tri dimensionet paraprake formulon rekomandime praktike dhe të ndjeshme ndaj gjinisë në nivel politikash. Këto rekomandime synojnë të:

- a) adresojnë boshllëqet dhe pabarazitë e identifikuar në përfaqësim dhe në qasjen ndaj burimeve;
- b) forcojnë qëndrueshmërinë klimatike të grave fermere përmes promovimit të qasjes së barabartë në informacion, financim dhe mundësi për ndërtim të kapaciteteve;
- c) inkurajojnë komunat që të integrojnë qasje të ndjeshme ndaj gjinisë në strategjitë e ardhshme bujqësore dhe në programet e subvencioneve, duke përfshirë dimensionin e qëndrueshmërisë klimatike.

Rekomandimet e politikave janë përshtatur për vendimmarrësit lokalë dhe do të prezantohen si pjesë e një analize avokuese të politikave. Analiza gjinore do të shërbejë jo vetëm si mjet për mësim institucional, por edhe si një udhërrëfyes i zbatueshëm për promovimin e barazisë gjinore dhe qëndrueshmërisë klimatike në sektorin e bujqësisë në komunat e Podujevës dhe Rahovecit.



Analiza e të dhënave


Përfaqësimi:

Në nivel lokal, institucionet përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave bujqësore janë Drejtoritë Komunale të Bujqësisë. Këto drejtori kanë për detyrë hartimin e politikave bujqësore, shpalljen e thirrjeve për subvencione, pjesëmarrjen në sesione informuese lidhur me mundësitë e përfitimit nga subvencionet, si dhe formimin e komisioneve për vlerësimin e aplikimeve përkatëse. Për këtë arsye, është thelbësore që këto institucione të jenë gjithëpërfshirëse në punën e tyre, duke siguruar që politikat, skemat e subvencioneve dhe aktivitetet e ndërlidhura të jenë të ndjeshme ndaj gjinisë dhe t'u përgjigjen nevojave specifike të grave dhe burrave fermerë. Hapi i parë në këtë drejtim është analizimi i përbërjes gjinore të stafit dhe, më pas, i pozitave që ata mbajnë.

Siç paraqitet në tabelën më poshtë, të dyja komunat kanë nga pesë (5) anëtarë të stafit secila. Në Podujevë, tri (3) prej tyre janë gra dhe dy (2) janë burra, ndërsa drejtorja udhëhiqet nga një grua. Kjo strukturë reflekton një nivel të lartë të përfaqësimit dhe udhëheqjes së grave, duke shërbyer si shembull pozitiv i arritjes së balancës gjinore në drejtoritë komunale të bujqësisë. Në të kundërt, në Rahovec vetëm një (1) anëtare e stafit është grua, ndërsa katër (4) të tjerët janë burra, dhe drejtorja drejtohet gjithashtu nga një burrë, çka dëshmon për nën-përfaqësimin e grave në këtë institucion. Vlen të theksohet se gjatë viteve 2022 dhe 2023, në Drejtorinë e Bujqësisë në Rahovec nuk kishte asnjë grua të punësuar.

■ FIGURA 01.

Përbërja gjinore e stafit në Drejtoritë e Bujqësisë në Podujevë dhe Rahovec



 Gra
 Burra





FIGURA 02.
Pagat për vitin 2024 in
Rahovec, Drejtoria e
Bujqësisë

Burimi: Komunikim
i drejtpërdrejtë me
komunën



Për më tepër, të dhënat e ndara sipas gjinisë mbi pagat në komunën e Rahovecit tregojnë se shpenzimet për paga dhe mëditje janë kryesisht të alokuara për punonjësit meshkuj. Kjo shpërndarje është në përputhje me përbërjen gjinore të drejtorisë, ku burrat përbëjnë shumicën e stafit. Nuk janë të disponueshme të dhëna të ndara sipas gjinisë për trajnimet apo vizitat studimore jashtë vendit. Ndërkohë, komuna e Podujevës nuk disponon fare të dhëna të tilla.

Për më tepër, thirrjet për subvencione bëhen nga zyrtarë të drejtorive përkatëse, dhe shumica janë burra në komunën e Rahovecit. Meqenëse përgatitja e këtyre thirrjeve është thelbësore për të siguruar që aspektet gjinore të merren parasysh dhe që gratë fermere të mos përjashtohen përmes kriterëve kufizues, është e rëndësishme që grupet punuese të përfshijnë përfaqësues të të dyja gjinive. Sipas informatave të ofruara nga Drejtoria e Bujqësisë, thirrjet përgatiten brenda institucionit nga stafi i drejtorisë, pa i kushtuar vëmendje të mjaftueshme balancës gjinore në përbërjen e komisioneve.³ Edhe pse sipas nenit 7 të Rregullores për Kriteret e Subvencioneve, përbërja e komisionit për vlerësimin e aplikimeve duhet të bazohet në parimin e barazisë gjinore dhe të përfshijë pesë (5) anëtarë.⁴

Analiza e thirrjeve për subvencione nuk identifikon dispozita, stimuj apo kërkesa të qarta që lidhen me zbutjen ose përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në të dyja bashkitë.

Në mënyrë të ngjashme, edhe në komunën e Podujevës, neni i 7 i Rregullores për Kriteret dhe Subvencionet, obligon formimin e komisioneve që reflektojnë parimin e barazisë gjinore.⁵ Megjithatë, në praktikë, sipas deklaratimit të përfaqësuesve të drejtorisë, “ne përpiqemi të përfshijmë gra në çdo komision; megjithatë, nuk kemi të dhëna lidhur me numrin e komisioneve dhe përbërjen e tyre sipas gjinisë”.⁶

Të gjitha komisionet, përfshirë ato përgjegjëse për vlerësimin e subvencioneve, emërohen nga kryetari i komunës. Asnjëra prej komunave nuk mbledh të dhëna mbi përbërjen gjinore të këtyre komisioneve. Megjithatë, komuna e Podujevës ka treguar një nivel ndërgjegjësimi sa i përket marrjes në konsideratë të barazisë gjinore, gjatë procesit të emërimit. Ndërsa komuna e Rahovecit nuk e ka përmendur balancën gjinore si faktor udhëzues në formimin e komisioneve.

3 Takim në Drejtorinë e Bujqësisë, Rahovec. 5 mars, 2025.

4 Komuna e Rahovecit. Rregullorja për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve. Pril 2017. E disponueshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15264>

5 Komuna e Podujevës. Rregullorja për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve. Pril 2022. E disponueshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=59474>

6 Takim në Drejtorinë e Bujqësisë, Podujevë. 18 shkurt 2025.

Burimet:

Në këtë pjesë analizohen të dhënat e ndara sipas gjinisë mbi subvencionet, përfshirë numrin e subvencioneve të ndara, modelet e aplikimit, kanalet përmes të cilave fermerët informohen për thirrjet për subvencione, si dhe mbështetjen e ofruar gjatë procesit të aplikimit.

Së pari, në komunën e Podujevës, të dhënat e paraqitura në Tabelën 3 për periudhën 2022–2024 tregojnë një hendek të vazhdueshëm gjinor në ndarjen e sub-

vencioneve. Gjatë kësaj periudhe tri vjeçare janë ndarë gjithsej 1,365 subvencione, prej të cilave 324 (rreth 24%) u janë dhënë grave dhe 1,041 (76%) burrave. Në vitin 2022, gratë përfituan 115 nga 602 subvencione, ndërsa në vitin 2023 ky numër ra në 95 nga 364. Edhe pse në vitin 2024 u shënua një rritje e lehtë, me 114 subvencione të ndara për gratë nga gjithsej 399, burrat mbetën përfituesit dominues në të tri vitet. Ky trend tregon një pabarazi të vazhdueshme në përfitimin e subvencioneve, pra se ka pengesa strukturore dhe informuese që dëshmojnë për një shpërpjestim në dhënieve të subvencioneve për gratë fermere.

■ **TABELA 01.** Numri i subvencioneve dhënë burrave dhe grave fermerë /e në Podujevë (2022-2024)

Viti	Gra	Burra	Totali
2022	115	487	602
2023	95	269	364
2024	114	285	399

Burimi: Komunikim i drejtpërdrejtë me komunën



Në përputhje me shpërndarjen e subvencioneve të paraqitura më sipër, edhe alokimi i mjeteve financiare në komunën e Podujevës gjatë periudhës 2022–2024 reflekton një pabarazi gjinore. Siç paraqitet në Tabelën 4, fermerët meshkuj kanë përfituar shumicën e shumës totale të subvencioneve në të tri vitet. Në vitin 2022, gratë përfituan 125,029.77 € (25.7%), krahasuar me 362,407.90 € (74.3%) të alokuara për burrat. Ky hendek vazhdoi edhe në vitin 2023, kur grave iu ndanë 227,780.00 € (28.1%), ndërsa burrave 584,492.50 € (71.9%). Një model i ngjashëm vërehet edhe në vitin

2024, me 287,934.26 € (28.9%) të alokuara për gratë dhe 708,425.74 € (71.1%) për burrat.

Edhe pse shuma totale e subvencioneve të ndara për gratë është rritur në mënyrë të vazhdueshme gjatë periudhës trivjeçare, burrat kanë vazhduar të përfitojnë një pjesë dukshëm më të madhe të fondeve. Kjo shpërndarje pasqyron pabarazitë gjinore të vërejtura në numrin e subvencioneve të ndara dhe tregon se dallimet në qasje reflektohen jo vetëm në nivelin e pjesëmarrjes, por edhe në shpërndarjen e përgjithshme të mbështetjes financiare.

■ **TABELA 02.** Shuma totale e subvencioneve (në euro) të ndara për gratë dhe burrat fermerë /e në Podujevë (2022–2024)

Shuma totale e parave 2022-2024

Viti	Gra 	Burra 	Totali
2022	125,029.77 €	362,407.90 €	487,437.67 €
2023	227,780.00 €	584,492.50 €	812,272.50 €
2024	287,934.26 €	708,425.74 €	996,360.00 €



Burimi: Komunikim i drejtpërdrejtë me komunën

Krahasimi i numrit të aplikimeve me numrin e subvencioneve të ndara tregon se numri më i ulët i përfitueseve gra është kryesisht në përputhje me pjesëmarrjen e tyre më të ulët në procesin e aplikimit. Në vitin 2022, 115 nga 251 gra aplikuese përfituan subvencione (45.8%), krahasuar me 487 nga 1,295 burra aplikues (37.6%). Në vitin 2023, 95 nga 147 gra aplikuese rezultuan të suksesshme (64.6%), ndërsa nga burrat përfituan 269 nga 450 aplikues (59.8%). Në mënyrë të ngjashme, në vitin 2024, 114 nga 236 gra aplikuese përfituan subvencione (48.3%), krahasuar me 285 nga 685 burra aplikues (41.6%).

Këto të dhëna na thonë se, ndonëse gratë fermere aplikojnë për subvencione në numër më të ulët, normat e tyre të suksesit janë të krahasueshme dhe, në disa vite, edhe më të larta sesa ato të burrave. Kjo tregon se është faza e aplikimit, jo procesi i vlerësimit, që përbën pikën kyçe ku shfaqen pabarazitë gjinore, duke theksuar rëndësinë e ndërhyrjeve të synuara në informim, shpërndarje të informacionit dhe mbështetje gjatë procesit të aplikimit për gratë fermere.

TABELA 03. Numri i aplikimeve për subvencione nga gratë dhe burrat fermerë në Podujevë (2022–2024)



Numri i aplikuesëve për periudhën 2022-2024

Viti	Gra 	Burra 	Totali
2022	251	1295	1546
2023	147	450	597
2024	236	685	921

Burimi: Komunikim i drejtpërdrejtë me komunën

TABELA 04. Numri i subvencioneve të ndara për fermerët /et në Rahovec

Numri i subvencioneve

Viti	Gra 	Burra 	Totali
2024	59	1857	1916

Burimi: Komunikim i drejtpërdrejtë me komunën

Çdo thirrje për subvencione bujqësore e shpallur nga komuna përfshin një masë afirmative të dizajnuar për të inkurajuar dhe mbështetur pjesëmarrjen e grave fermere. Në kuadër të kësaj mase, aplikantët gra përfitojnë pikë shtesë gjatë procesit të vlerësimit, duke rritur gjasat e tyre për përzgjedhje.⁷ Megjithatë, ndonëse kjo masë ka treguar rezultate pozitive në rritjen e angazhimit të grave, ajo aktualisht zbatohet si iniciativë e brendshme e drejtorisë dhe nuk është e rregulluar formalisht në Rregulloren për Kriteret dhe Subvencionet. Thirrjet për subvencione publikohen në uebfaqen e komunës dhe shpërndahen përmes rrjeteve sociale. Përveç kësaj, organizohen dëgjime buxhetore me qëllim të mbledhjes së shqetësimeve dhe nevojave të grave dhe burrave fermerë në të gjithë komunën.

Së dyti, në komunën e Rahovecit, gratë fermere përbëjnë vetëm një përqindje shumë të vogël të përfituesve të subvencioneve. Të dhënat tregojnë se gjatë vitit 2024, rreth 4% e fermerëve që përfituan subvencione nga thirrjet e ndryshme komunale ishin gra, ndërsa rreth 96% ishin burra. Sipas Drejtorisë së Bujqësisë, të dhënat për vitet paraprake nuk janë të regjistruara në format të digjitalizuar dhe mbledhja e tyre kërkon kohë të konsiderueshme, pasi do të duhej shqyrtimi individual i secilës dosje të fermerëve.

Kjo pabarazi e theksuar dëshmon për një hendek të thellë gjinor në qasjen ndaj mbështetjes bujqësore komunale. Për më tepër, komuna nuk mbledh të dhëna të ndara sipas gjinisë lidhur me shumën e mbështetjes financiare të ndarë për secilin përfitues apo llojin e pajisjeve të ofruara, pasi këta elementë nuk analizohen përmes një lente gjinore.⁸ Kjo mungesë e të dhënave të ndara sipas gjinisë kufizon ndjeshëm politikëbërjen e bazuar në prova dhe integrimin e parimeve të buxhetimit të ndjeshëm gjinor në skemat komunale të mbështetjes bujqësore.

Informimi për thirrjet për subvencione në komunën e Rahovecit bëhet përmes uebfaqes së komunës dhe kanaleve zyrtare të rrjeteve sociale. Megjithatë, komuna nuk zbaton iniciativa apo fushata informuese të dizajnuara posaçërisht për të informuar dhe përfshirë gratë fermere. Për më tepër, asnjë nga thirrjet për subvencione nuk përfshin masa afirmative për reduktimin e pabarazive gjinore në përfitimin nga skemat komunale të mbështetjes bujqësore. Aplikimet vlerësohen vetëm mbi bazën e kriteve të përgjithshme të përcaktuara në thirrje, pa masa shtesë që do të ndihmonin në zbutjen e barrierave strukturore me të cilat përballen gratë fermere.

⁷ Takim në Drejtorinë e Bujqësisë, Podujevë. 18 shkurt, 2025.

⁸ Takim në Drejtorinë e Bujqësisë, Rahovec. 5 mars, 2025.

Në tërësi, këta faktorë kontribuojnë në përfaqësimin e pamjaftueshëm të grave ndër përfituesit e subvencioneve dhe nxjerrin në pah nevojën për qasje më proaktive dhe të ndjeshme ndaj gjinisë në hartimin dhe zbatimin e skemave komunale të subvencioneve bujqësore.

Nga perspektiva e qëndrueshmërisë klimatike, pjesëmarrja e kufizuar e grave fermere në skemat komunale të subvencioneve ngre shqetësime lidhur me gjithëpërfshirjen dhe efektivitetin e përpjekjeve lokale për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Subvencionet bujqësore luajnë rol kyç në mbështetjen e investimeve në praktika rezistente ndaj klimës, siç janë sistemet e përmirësuara të ujitjes, kulturat rezistente ndaj thatësisë, serrat me efikasitet energjetik dhe menaxhimi i qëndrueshëm i blegtorisë. Përfaqësimi i pamjaftueshëm i grave ndër përfituesit e subvencioneve në Rahovec sugjeron se gratë fermere mund të kenë qasje më të kufizuara në burime që po bëhen gjithnjë e më thelbësore për përshtatjen ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

Në mungesë të të dhënave të ndara sipas gjinisë mbi llojin dhe shkallën e mbështetjes së ofruar, komuna nuk është në gjendje të vlerësojë nëse investimet e lidhura me klimën arrijnë në mënyrë të barabartë tek gratë dhe burrat fermerë, çka rrezikon të përforcojë cënueshmëritë ekzistuese përballë rreziqeve klimatike.

Gjendja reale:

Ky dimension shqyrton faktorët themelorë socialë, kulturorë dhe institucionalë që formësojnë pabarazitë gjinore të identifikuar në dimensionet e Përfaqësimit dhe Burimeve. Ndërsa të dhënat sasiore nxjerrin në pah qasjen e pabarabartë ndaj subvencioneve dhe strukturave të vendimmarrjes, dimensionin *Gjendja reale (Realia)* synon të shpjegojë arsyet e qëndrueshmërisë së këtyre pabarazive përmes eksplorimit të përvojave të jetuara, normave shoqërore dhe praktikave institucionale në nivel lokal.

Për të kapur këto dinamika, janë zhvilluar dy diskutime në fokus grupe, nga një në secilën komunë, me gra dhe burra fermerë, si dhe nga një intervistë gjysmë e strukturuar në secilën komunë me përfaqësues të drejtorive komunale të bujqësisë. Këto metoda cilësore ofrojnë njohuri të drejtpërdrejta mbi mënyrën se si gjinia, ndryshimet klimatike dhe qeverisja lokale ndërthuren në formësimin e qasjes së fermerëve ndaj mekanizmave komunalë të mbështetjes.

Gjatë diskutimeve në fokus grupe, gratë fermere identifikuan një sërë faktorësh të ndërlidhur që formësojnë qasjen e tyre ndaj financimit komunal dhe kapacitetin për t'u angazhuar në masa për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Këta faktorë përfshijnë barrën e lartë të punës së papaguar të kujdesit dhe punëve shtëpiake, qasjen e kufizuar në informacion të hershëm dhe të synuar për mundësitë e subvencioneve, mungesën e aftësive digjitale për të naviguar procedurat e aplikimit, si dhe kriteret kufizuese të pranueshmërisë, siç janë kërkesat për bashkëfinancim.

Pjesëmarrëset gjithashtu theksuan se dizajni i standardizuar i thirrjeve për subvencione shpesh nuk pasqyron nevojat e ndryshme dhe realitetet prodhuese të grave fermere, as ndryshimet e vazhdueshme dhe rreziqet që lidhen me ndryshimet klimatike. Këto perceptime përputhen me analizën e dokumenteve të thirrjeve për subvencione, e cila nuk gjeti mbështetje apo referencë të qartë për zbutjen ose përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në asnjërinë nga bashkitë. Për më tepër, gratë raportuan nivel të kufizuar njohurish dhe vetëdijeje mbi ndryshimet klimatike dhe implikimet e tyre për punën bujqësore, çka e kufizon më tej aftësinë e tyre për të adoptuar praktika rezistente ndaj klimës.

Gratë fermere raportuan se ndryshimet klimatike po prishin gjithnjë e më shumë kalendarët tradicionalë bujqësorë dhe ciklet e prodhimit, duke krijuar pasiguri dhe ngarkesa shtesë në punën e tyre të përditshme. Pjesëmarrëset përshkruan ndryshime të qarta në modelet sezonale, përfshirë vonesa në periudhat e mbjelljes dhe korrjes, muaj jashtëzakonisht të ftohtë ose të ngrohtë, si dhe luhatje të paparashikueshme të motit. Siç vuri në dukje një grua: “Më 1 korrik dolën specat, pothuajse një muaj më vonë se zakonisht”, ndërsa një tjetër shpjegoi se temperaturat jashtëzakonisht të ulëta në muajin maj e kishin detyruar të shtynte mbjelljen.

Pjesëmarrëset përshkruan edhe ndryshime të dukshme mjedisore, siç është rënia e gjetheve sikur në vjeshtë për shkak të ndryshimeve të menjëhershme të temperaturave, duke ilustruar se si kushtet klimatike të paqëndrueshme po ndikojnë në zhvillimin e kulturave bujqësore dhe planifikimin e prodhimit. Këto ndryshime përkeqësohen nga sfidat në rritje që lidhen me menaxhimin e ujit, pasi thatësitat e zgjatura dhe modelet e parregullta të reshjeve kufizojnë kapacitetin prodhues. Gratë theksuan nevojën për sisteme të ruajtjes së ujit, ujitje dhe mbështet-

je komunale, duke nënvizuar se sistemet e ujitjes me pika do ta përmirësonin ndjeshëm cilësinë e prodhimit, por mbeten financiarisht të paarritshme. Siç u shpreh një pjesëmarrëse: “Ne përpiqemi të kursejmë ujë, të ndërtojmë rezervuarë, por na duhet mbështetja e komunës”, ndërsa një tjetër theksoi se mungesa e lagështisë ndikon drejtpërdrejt si në rendimentin e kulturave, ashtu edhe në rezistencën ndaj sëmundjeve.

Ndërkohë, një grua fermere theksoi se barra e rëndë e punës së papaguar bie plotësisht mbi supet e saj, duke shpjeguar: “Në orën 6 të mëngjesit kujdesem për lopët dhe pulat, përgatis mëngjesin dhe drekën për vjehrrit dhe fëmijët, pastaj dal në ara, kthehem të bëj punët e shtëpisë dhe hekurosjen, dhe vetëm atëherë shkoj të fle.” Një fermere tjetër vuri në dukje se kushtet e ndryshuara klimatike tani e detyrojnë të zgjohet edhe më herët për të përfunduar punët në fushë.

Këto dëshmi tregojnë se gratë fermere përballen me një ngarkesë të shpërpjestuar pune e në rritje, duke kombinuar punën bujqësore me përgjegjësi të gjera të paguara të kujdesit dhe punëve shtëpiake. Me rritjen e presioneve klimatike, këto detyrime të mbivendosura e kufizojnë edhe më tej kohën e tyre për pushim dhe/ose pjesëmarrje në proceset e vendimmarrjes.

Në të njëjtën kohë, gratë fermere theksuan mungesën e qasjes në trajnime praktike, shërbime këshillimore bujqësore dhe asistencë teknike që do t’u mundësonin t’u përgjigjen më efektivisht sfidave të lidhura me ndryshimet klimatike. Pjesëmarrëset shprehën nevojë të theksuar për udhëzime mbi praktikat bujqësore rezistente ndaj klimës, trajtimin natyror të sëmundjeve dhe përdorimin e pajisjeve moderne, duke vënë në dukje se inputet bujqësore janë të kushtueshme dhe se shumë gra nuk kanë aftësitë e nevojshme për të operuar makineri të reja. Siç shpjegoi një grua: “Më parë mbillnim me dorë, tani bëhet me makina, dhe gratë nuk dinë t’i përdorin”, ndërsa të tjera theksuan nevojën për mbështetje nga agronomët për të ditur çfarë të mbjellin dhe si t’i mbrojnë kulturat nga ndikimet klimatike.

Në tërësi, këto përvoja nxjerrin në pah se ndryshimet klimatike, të kombinuara me mbështetje të kufizuara institucionale, mungesë trajnimesh dhe qasje të pamjaftueshme në teknologji, prekin në mënyrë disproporcionale gratë fermere dhe e kufizojnë aftësinë e tyre për t’u përshtatur dhe për të ndërtuar qëndrueshmëri në sektorin bujqësor.

Për më tepër, gratë fermere identifikuan kërkesat për bashkëfinancim dhe pronësinë e kufizuar të tokës si dy barriera strukturore të ndërlidhura në qasjen ndaj subvencioneve komunale dhe kredive. Obligimi për të siguruar një kontribut financiar prej 30% prek në mënyrë disproporcionale gratë, veçanërisht ato të angazhuara në bujqësi në shkallë të vogël, të cilat shpesh nuk disponojnë kursime apo qasje në burime formale financiare. Kjo pengesë përforcohet më tej nga fakti se toka bujqësore është kryesisht e regjistruar në emër të burrave, duke kufizuar aftësinë e grave për të aplikuar në mënyrë të pavarur për grante, për të siguruar kredi apo për të ofruar kolateralin e kërkuar nga institucionet financiare.

Sipas Anketës më të fundit Bujqësore të Kosovës (2015), burrat zotërojnë 95.1% të pronësisë mbi tokën bujqësore, ndërsa gratë vetëm 4.9%. Megjithatë nuk ka një anketë më të fundit, një studim i vitit 2024 nga Kosovo Women’s Network zbuloi se vetëm 3% e grave rurale të anketuara raportuan se zotërojnë tokë bujqësore. Kjo pabarazi e theksuar nxjerr në pah pengesa strukturore të vazhdueshme që kufizojnë pavarësinë ekonomike dhe fuqinë vendimmarrëse të grave në zonat rurale.⁹

Si rezultat, shumë gra fermere mbeten të përjashtuara nga skemat e subvencioneve dhe mundësitë e kreditimit, duke përforcuar pabarazitë ekzistuese gjinore në qasjen ndaj mbështetjes bujqësore.

⁹ FAO. 2024. Profili gjinor i bujqësisë dhe jetesës rurale në Kosovë. Hartuar nga Kosovo Women’s Network në Kosovë. I disponueshëm në <https://doi.org/10.4060/cd1154en>

Rekomandimet:

Kjo pjesë konsolidon gjetjet nga dimensionet para-prake analitike për të zhvilluar rekomandime praktike dhe të ndjeshme ndaj gjinisë në nivel politikash, të cilat synojnë reduktimin e pabarazive, forcimin e qëndrueshmërisë klimatike të grave fermere dhe mbështetjen e komunave në integrimin e qasjeve të ndjeshme ndaj gjinisë dhe rezistente ndaj klimës në strategjitë bujqësore dhe skemat e subvencioneve.

1 Rikonceptimi i skemave komunale të subvencioneve për të eliminuar barrierat strukturore për gratë fermere

Komunat në konsultim me gra fermere, duhet të rishikojnë kriteret e pranueshmërisë me qëllim të reduktimit të barrës së bashkëfinancimit për gratë dhe fermerët në shkallë të vogël, për shembull përmes vendosjes së normave më të ulëta të bashkëfinancimit, modaliteteve fleksibile të pagesës ose krijimit të dritareve të dedikuara për ferma të udhëhequra nga gratë. Këto masa do të adresonin drejtpërdrejt përjashtimin strukturor që buron nga qasja e kufizuar në burime financiare.

2 Institucionalizimi i qeverisjes klimatike të ndjeshme ndaj gjinisë në nivel komunal

Komunat në përputhje me kërkesat ligjore për buxhetim të ndjeshëm gjinor, duhet të mbledhin dhe të përdorin në mënyrë sistematike të dhëna të ndara sipas gjinisë mbi aplikimet për subvencione, miratimet dhe shumat e ndara, si dhe të integrojnë indikatorë gjinorë dhe klimatikë në planifikimin dhe monitorimin bujqësor. Vendosja e mekanizmave të qartë të llogaridhënies, siç janë rishikimet vjetore të ndikimit gjinor dhe klimatik të skemave të subvencioneve, do të siguronte që rregullimet e politikave të bazohen në prova dhe t'u përgjigjen realiteteve të grave fermere.

3 Institucionalizimi i masave afirmative për gratë fermere në rregulloret e subvencioneve

Mekanizmi i pikëve shtesë për aplikantët gra, i zbatuar në komunën e Podujevës, ka dëshmuar efektivitet, pasi normat e suksesit të grave janë të barabarta ose më të larta se ato të burrave sapo ato aplikojnë. Kjo masë duhet të përfshihet formalisht në Rregulloren Komunale për Kriteret dhe Subvencionet dhe të shtrihet edhe në komunën e Rahovecit. Kodifikimi i masave afirmative do të siguronte vazhdimësi përtej niveleve individuale të drejtorive dhe do të forconte qasjen e grave fermere në investime rezistente ndaj klimës.

4 Institucionalizimi i komisioneve me përfaqësim të balancuar gjinor për hartimin dhe vlerësimin e subvencioneve

Të dyja komunat duhet të kërkojnë formalisht që të gjitha grupet punuese dhe komisionet përgjegjëse për hartimin dhe vlerësimin e thirrjeve për subvencione të reflektojnë balancë gjinore dhe të përfshijnë ekspertizë në fushën e gjinisë dhe klimës. Vendimet e emërimit nga kryetarët e komunave duhet të udhëhiqen nga kriteret të qarta të barazisë gjinore, ndërsa përputhshmëria me këto kriteret duhet të monitorohet në baza vjetore.

5 Integrimi i qëndrueshmërisë klimatike dhe barazisë gjinore në dizajnimin e thirrjeve për subvencione

Thirrjet për subvencione duhet të japin përparësi në mënyrë të qartë investimeve rezistente ndaj klimës që u përgjigjen nevojave të grave fermere, siç janë sistemet e ujitjes me pika, infrastruktura për ruajtjen e ujit, farat rezistente ndaj klimës dhe mekanizmat në shkallë të vogël. Këto investime u përgjigjen drejtpërdrejt nevojave të jetuara të grave lidhur me thatësitat, motin e paparashikueshëm dhe rënien e rendimenteve, dhe do të forconin ndjeshëm kapacitetin e tyre për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike, njëkohësisht duke përmirësuar produktivitetin dhe sigurinë e të ardhurave.

6 Forcimi i informimit dhe qasjes së synuar për gratë fermere

Drejtoritë komunale të bujqësisë duhet të zhvillojnë strategji të përshtatura komunikimi për të siguruar që gratë fermere të marrin informacion të hershëm, të qasshëm dhe të kuptueshëm mbi mundësitë e subvencioneve dhe mbështetjen e lidhur me klimën. Këto strategji duhet të përfshijnë sesione informuese në komunitet, udhëzime të thjeshtuara për aplikim dhe komunikim të drejtpërdrejtë përmes shoqatave të grave dhe organizatave, këshillave të fshatrave dhe kooperativave bujqësore. Qasja proaktive në informim është thelbësore për të kapërcyer boshllëqet aktuale në qasje ndaj informacionit dhe barrierat digjitale të identifikuar nga gratë fermere.

7 Zgjerimi i shërbimeve këshillimore bujqësore të ndjeshme ndaj klimës për gratë fermere

Komunat duhet të krijojnë ose të forcojnë shërbimet këshillimore bujqësore me fokus të veçantë tek gratë fermere dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike. Kjo përfshin trajnime praktike dhe të drejtpërdrejta mbi praktikat bujqësore rezistente ndaj klimës, menaxhimin e ujit, kontrollin natyror të sëmundjeve dhe përdorimin e pajisjeve moderne. Shërbimet mobile të agronomëve dhe demonstrimet në terren mund të sigurojnë që mbështetja teknike të arrijë tek gratë që nuk kanë mundësi të qasen lehtë në qendrat e centralizuara të trajnimit.

8 Ndërtimi i kapaciteteve financiare dhe digjitale të grave për bujqësi rezistente ndaj klimës

Komunat, në bashkëpunim me institucionet financiare dhe organizatat e shoqërisë civile, duhet të ofrojnë mbështetje të synuar për forcimin e njohurive financiare dhe aftësive digjitale të grave, përfshirë trajnime mbi përgatitjen e aplikimeve për subvencione, menaxhimin e bashkëfinancimit dhe qasjen në kredi. Kjo do të reduktonte varësinë nga anëtarët meshkuj të familjes dhe do t'u mundësonte grave të angazhohen në mënyrë më të pavarur në investime bujqësore inteligjente ndaj klimës.

9 Të dyja komunat duhet të përfshijnë një analizë gjinore në kornizat e tyre buxhetore

dhe të publikojnë një deklaratë shoqëruese të buxhetimit të ndjeshëm gjinor së bashku me buxhetin vjetor, duke përfshirë objektiva të qarta për të adresuar pabarazitë e identifikuar, si dhe tregues, vlera fillestare dhe synime. Kjo do të mbështeste alokimin e synuar të subvencioneve për gratë, do të forconte monitorimin dhe do të rriste transparencën dhe llogaridhënien në planifikimin dhe shpenzimet buxhetore komunale.

Përfundime

Kjo analizë shqyrtoi pabarazitë gjinore dhe mundësitë në sektorin e bujqësisë që rrjedhin nga ndryshimet klimatike në komunat e Podujevës dhe Rahovecit. Analiza vlerëson mënyrën se si skemat komunale të subvencioneve, normat dhe praktikat socio-kulturore, dhe praktikat institucionale ndikojnë në kapacitetin e grave fermere për t'u përshtatur me rreziqet klimatike dhe ndryshimet mjedisore.

Gjetjet tregojnë pabarazi të vazhdueshme gjinore në të katër dimensionet e analizës. Gratë fermere vazhdojnë të përballen me disavantazhe strukturore, jo për shkak të mungesës së aftësive, motivimit apo angazhimit në bujqësi, por si rezultat i barrierave sistematike të rrënjësura në procedurat dhe kulturën institucionale komunale. Këto barrierat përfshijnë kritere financiare kufizuese për përfitim, qasje të pabarabartë në tokë dhe mjete prodhuese, përfaqësim të kufizuar në proceset vendimmarrëse, si dhe barrën disproporcionale të punës së papaguar të kujdesit dhe punëve shtëpiake, e cila kufizon mundësitë e grave për të përfituar nga mekanizmat e mbështetjes publike.

Analiza identifikon gjithashtu një boshllëk të qartë në reagimet politike në nivel komunal, pasi përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike nuk është e integruar drejtpërdrejt në skemat e subvencioneve bujqësore. Pavarësisht rritjes së rreziqeve klimatike, strukturat e granteve dhe afatet kohore të zbatimit mbeten kryesisht të pandryshuara. Kjo mungesë dinamike në politikëbërje kufizon kapacitetin përshtatës dhe rrezikon të përforcojë pabarazitë ekzistuese gjinore në qasje ndaj burimeve, produktivitetit dhe siguri të të ardhurave.

Në përgjithësi, integrimi i qasjeve të ndjeshme ndaj gjinisë dhe klimës në politikat lokale bujqësore është thelbësor për avancimin e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor. Duke adresuar pabarazitë në përfaqësim, qasje në burime dhe njohjen institucionale të punës së papaguar, autoritetet lokale mund të krijojnë një mjedis politik më gjithëpërfshirës dhe më mbështetës. Një qasje e tillë do të sigurojë që si gratë ashtu edhe burrat fermerë të jenë të pozicionuar në mënyrë të barabartë për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike, për të kontribuar në rritjen bujqësore dhe për të përfituar nga investimet publike.

Rekomandimet e paraqitura në këtë analizë ofrojnë një udhërrëfyes praktik për veprime në nivel komunal. Ato fokusohen në reformimin e kritereve të subvencioneve, rritjen e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, përmirësimin e qasjes në burime financiare dhe teknike, si dhe mbledhjen e të dhënave të ndjeshme ndaj gjinisë. Në tërësi, këto masa synojnë avancimin e barazisë gjinore duke integruar perspektivën gjinore në politikat bujqësore që janë miqësore me klimën, duke forcuar njëkohësisht kapacitetin përshtatës dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të sektorit bujqësor në Podujevë dhe Rahovec.

ANEKSI I: Pyetjet udhëzuese për grupet e fokusit

1. Përvoja në bujqësi

- a) Na tregoni shkurtimisht për aktivitetin tuaj bujqësor.
- b) Sa vite keni që punoni tokën dhe çfarë kultivoni?

2. Ndryshimet klimatike

- a) A keni vërejtur ndryshime në kushtet e motit gjatë viteve të fundit?
- b) Si i përjetoni këto ndryshime klimatike në fermën tuaj dhe në jetën e përditshme?
- c) Si kanë ndikuar këto ndryshime në rendimentet dhe të ardhurat tuaja?

3. Sfidat specifike dhe roli i grave

- a) Cilat janë sfidat më të mëdha që keni përjetuar vitet e fundit si pasojë e ndryshimeve klimatike (p.sh. thatësira, mungesa e ujit, reshje të tepruara/përmbytje, sëmundje të bimëve apo blegtorisë)?
- b) Si ndikon kjo situatë në rolin dhe përgjegjësitë tuaja si grua në familje dhe në komunitet?
- c) A mendoni se zëri i grave fermere dëgjohet kur diskutohen politikat bujqësore dhe klimatike në komunitetin tuaj?

4. Qasja në subvencione dhe barrierat e pjesëmarrjes

- a) Sa kohë keni në dispozicion për t'i plotësuar formularët për subvencione (një ose dy ditë, apo kjo ndërhyr në punët e tjera dhe obligimet familjare)?
- b) A keni njohuri të nevojshme për të plotësuar formularët?
- c) A ju ka ndodhur ndonjëherë të mos aplikoni për

një projekt të caktuar komunal për shkak se nuk kishit kohë ta zbatonit (p.sh. për shkak të përgjegjësisive të kujdesit)?

- d) A keni identifikuar ndonjë kriter në thirrjet për subvencione që ju ka përjashtuar automatikisht nga aplikimi?
- e) A jeni konsultuar ndonjëherë nga komuna gjatë hartimit të thirrjeve për subvencione?
- f) A keni pasur mjete ose financimin paraprak të nevojshëm, në rastet kur udhëzimet kërkonin pronësi ose bashkëfinancim për të përfituar subvencione?

5. Strategjitë e përdorura për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike

- a) Çfarë strategjish po përdorni për t'u përballur me këto ndryshime?
- b) Si po përpiqeni t'i tejkaloni këto sfida?
- c) A keni marrë ndonjë mbështetje nga komuna, ministria përkatëse ose organizata të tjera për t'u përballur me pasojat e ndryshimeve klimatike?
- d) A keni pasur qasje në informacion, trajnime apo këshilla mbi bujqësinë e qëndrueshme ose përshtatjen ndaj klimës?

6. Nevojat dhe rekomandimet

- a) Çfarë lloj mbështetjeje konkrete do t'ju ndihmonte më së shumti për t'u përballur me ndryshimet klimatike (p.sh. grante, teknologji, fara rezistente, trajnime)?
- b) A jeni të interesuara të bashkoheni në një rrjet, grup apo kooperativë për mbështetje të ndërsjellë dhe shkëmbim përvojash?

ANEKSI II: Pyetjet udhëzuese për intervistat gjysmë të strukturuar me komunat

A. Qasja në subvencione dhe kriteret e pranueshmërisë

1. Cilat janë kriteret kryesore të pranueshmërisë për subvencione ose grante bujqësore në këtë komunë?
2. A keni identifikuar ndonjë kriter (p.sh. pronësia e tokës, kërkesat për bashkëfinancim) që mund të përjashtojë në mënyrë të paqëllimshme gratë ose fermerët në shkallë të vogël?

B. Procesi i aplikimit dhe barra administrative

3. Sa është i qasshëm procesi i aplikimit për subvencione (p.sh. dokumentacioni, qasja digjitale)? A keni marrë ndonjë feedback mbi barrierat me të cilat përballen aplikuesit?
4. A ofrohet ndonjë asistencë për fermerët që kanë vështirësi në plotësimin e aplikimeve për shkak të mungesës së kohës ose njohurive teknike?

C. Buxheti i ndjeshëm ndaj gjinisë dhe mbështetja institucionale

5. A merret parasysh dimensionin gjinor në planifikimin financiar dhe ndarjen e subvencioneve bujqësore?
6. A ka realizuar drejtoria ndonjë vlerësim ose analizë mbi shpërndarjen e subvencioneve sipas gjinisë?

